



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E ARSIMIT RINISË DHE SPORTEVE

Nr. _____ Prot

Lezhë më. ____ . ____ . 2022

Lënda: Ftesë për pjesëmarrje në Kampionatin e Volejbollit mes Institucioneve.

KËTU

- 1- Drejtorisë AKU (Agjensia e Kontrollit të Ushqimeve)Lezhë
- 2- Drejtorisë së Sigurimeve Shoqërore Lezhë
- 3- Drejtorisë ASHK (Agjensia Shtetërore e Kadastrës)Lezhë
- 4- Drejtoria e Tatimeve Lezhë
- 5- Drejtoria e OSHEE Lezhë
- 6- Drejtoria e Postës Lezhë
- 7- Drejtoria e Policisë Lezhë
- 8- Drejtoria e ADZM (Zonat e Mbrojtura) Lezhë
- 9- Drejtorisë së Portit Lezhë
- 10- Drejtoria e DSHP (Shëndetit Publik) Lezhë
- 11- Drejtoria e Spitalit Rajonal Lezhë
- 12- Drejtoria e DRAP(Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar) Lezhë
- 13- Dhomës së Tregtisë Lezhë
- 14- Dhomës së Avokatisë Lezhë
- 15- Qarkut Lezhë
- 16- Zyrës së Punës Lezhë

Drejtoria e Arsimit Rinisë dhe Sporteve sipas kalendarit të aktiviteteve sportive vjetore 2022 , do të zhvillojë Kampionatin e Volejbollit mes Institucioneve. Ky aktivitet sportiv ka si synim aktivizimin e punonjësve të Institucioneve dhe Drejtorive të Lezhës, duke i nxjerë nga monotonia e zyrës dhe duke i bashkuar në fushën e volejbollit. Të argëtohem dhe të djegim disa kalori më shumë nëpërmjet aktivitetit fizik.

Pjesëmarrja në aktivitet duhet të ketë disa rregulla nga secili ekip si:

- 1- Përbërja e ekipit duhet të jetë me 8-10 lojtarë , 6 në fushë dhe 2-4 rezervë për të mbuluar mungesat apo demtimet e mundëshme gjatë aktivitetit.
 - 2- Përfaqësimi i femrave në ekip është detyrim ku nga 6 lojtarë ne fushë 2 duhet të jenë femra.
 - 3- Lojtarët që do përfaqësojnë ekipin nuk mund të merren nga jashtë institucioneve, apo nga Drejtori të tjera.
 - 4- Ekipi që nuk paraqitet ditën e ndeshjes humbet atë ndeshje direkt.
 - 5- Ekipet kanë të drejtë ndërrimi të lojtarëve gjatë lojës vetëm me lojtarët e konfirmuar në listat e tyre.
 - 6- Ekipet duhet të përfaqësohen me bluzen me logon e Institucionit që përfaqësojnë.
 - 7- Vendimet e Arbitrit nuk diskutohen gjatë lojës pasi Arbitri është personi vendimarrës për lojën.
 - 8- Hedhja e Shortit do të bëhet në prani të përfaqësuesve të ekipeve pjesëmarrëse.
- Kampionati do të zhvillohet tek palestra e Gjimnazit “HYDAJET LEZHA”

SHËNIM: Deri me date 7 NËNTOR ditën e hënë jemi në pritje të konfirmimit tuaj për pjesëmarrje në aktivitet.

Me datën 9 Nëntor ditën e mërkurë bëhet shorti tek QKF në orën 14:00. ku secili ekip duhet të dërgojë përfaqësuesin e tij për të tërhequr shortin.

Kampionati do të startojë me date 11 nëntor ditën e premte me dy ekipet e para në short , për orën do të vendosim pas shortit bashkarisht me ju.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Reinis Çela

KRYETARI

Pjerin NDREU